



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"  
REKTORATI

Nr. 349 Prot.

Gjirokastrër, më 23.03 / 2022

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me Universitetin IES Ribeira Do Luoro të Spanjës.

Në kuadër të Programit Erasmus+, Universiteti IES Ribeira Do Luoro i Spanjës ka fituar një grant për kërkim shkencor dhe trajnim në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes kërkohet që Universiteti i Gjirokastrës të marrë pjesë me:  
**4 pozicione** për staf akademik të cilët do të angazhohen në trajnim për periudhën 18-22 Prill 2022 në Universitetin IES Ribeira Do Luoro.

Gjuha e përdorur do të jetë anglisht në nivelin B2 për stafin akademik për trajnim. Sipas të dhënave nga Universiteti IES Ribeira Do Luoro, aplikimet janë të hapura për Fakultetin Ekonomik. Nëse jeni të interesuar, lutemi të dërgoni pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **01.04.2022**:

- një letër interesi, në shqip dhe anglisht.
- një CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në shqip dhe në anglisht.
- një provë / çertifikatë të njohurive të gjuhës angleze sipas niveleve të specifikuara më sipër.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ dhe më pas ky vlerësim do t'i përcillet palës së Universitetit IES Ribeira Do Luoro, për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

